



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2018:016931

Datë: 23.08.2021

Numri i dokumentit: 02107718

P.nr.1012/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Shpresa Emra, me bashkëpunëtorin profesional Uran Zogaj, në çështjen penale kundër të akuzuarit F.H., nga Prizreni, për shkak të veprës penale sulmi nga neni 187 par. 1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Kosovës nr. 04/L-082 (KPK), sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren, PP/II nr.2220-3/17 e datës 25.01.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në prezencën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, Prokurorit të Shtetit Fatos Ajvazi, të akuzuarit F.H., më datë **13.08.2021**, mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari,

F.H., nga i ati dhe e ëma, e lindur, i lindur më, në Prizren, ku edhe tani banon, në rrugën "....." nr., ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal

ËSHTË FAJTOR

Se më datë 13.08.2017, rreth orës 01:50, në Prizren, në rrugën "Adem Jashari" te lokali ".....", me dashje e përdor forcën bashkë me të pandehurin V.H., ndaj të dëmtuarit D.A., për shkak të një mosmarrëveshje, e sulmojnë me grushte të dëmtuarin pa dashjen e tij.

Me këto veprime në bashkëkryerje ka kryer veprën penale sulmi nga neni 187 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPK-së.

Andaj gjykata sipas dispozitave ligjore të lartcekura dhe në harmoni me nenet 7, 8, 9, 10, 41, 42, 43, 46, 73, 74 të KPK-së dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, të akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Në shumën prej **150 € (njëqind e pesëdhjetë) euro**, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar ta paguajë në afatin prej 15 ditësh, pas ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk mund apo nuk dëshiron ta paguajë dënimin me gjobë, atëherë gjykata konform nenit 46 par. 3 të KPK-së, dënimin me gjobë, do t'ia zëvendësoj me dënim me burgim, ashtu që për çdo 20 € (njëzet) euro llogaritet 1 (një) ditë burgim.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € dhe në emër të fondit për kompensim të viktimave shumën prej 30 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

I dëmtuari D.A., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, pranë kësaj gjykate ka parashtruar Aktakuzën PP/II. nr. 2220-3/17 e datës 25.01.2018, kundër të akuzuarit D.A., nga Prizreni, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor, nga neni 188 par. 1 nën par. 1.4. të KPK-së dhe të akuzuarve: V.H., dhe F.H., që të dy nga Prizreni, për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer veprën penale sulmi, nga neni 187 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Me aktgjykimin e kësaj gjykate P.nr.107/2018 të datës 09.11.2020, të akuzuarit: D.A., dhe V.H., janë shpall fajtorë dhe janë dënuar me dënim me gjobë në shumën përkatëse të cekur në aktgjykim.

Në vazhdim, me aktvendimin e kësaj gjykate P.nr.107/2018 të datës 09.11.2020, është veçuar procedura penale ndaj të akuzuarit F.H., dhe lënda është proceduar ndaras dhe me numër të ri pranë kësaj gjykate.

Gjykata në këtë çështje penale, ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar më datë 13.08.2021, në të cilin shqyrtim i akuzuari ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës. Gjithashtu, i akuzuari shtoi se është e vërtetë që rasti ka ndodhur në vitin 2017, i vjen keq për atë çka ka ndodhur, i premtonte gjykatës që në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm e të mos përsërisë më vepra të tilla.

Prokurori i shtetit nuk e kundërshtoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit.

Bazuar në pranimin e fajësisë dhe konform dispozitave të nenit 246 e 248 të KPPRK-së, gjykata nuk është lëshuar në procedimin e provave.

Gjykata në shqyrtimin fillestar nga pranimi i fajësisë së të akuzuarit dhe provave materiale në shkresat e lëndës, ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Është vërtetuar se i akuzuari, më datë 13.08.2017, rreth orës 01:50, në Prizren, në rrugën "Adem Jashari" te lokali ".....", me dashje e përdor forcën bashkë me të pandehurin V.H., ndaj të dëmtuarit D.A., për shkak të një mosmarrëveshjeje, e sulmojnë me grushte të dëmtuarin pa dashjen e tij.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, i cili vullnetarisht ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, për shkak të së cilës gjykata fare nuk ka administruar provat.

Sipas detyrës zyrtare, gjykata konform nenit 257 të KPPRK-së, nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë për veprën penale e cila i vihet në barrë e që pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzime. Pranimi i fajësisë mbështetet në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me kohë me të gjitha provat materiale.

Gjykata erdhi në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 248 të KPPRK-së dhe faktet që përmban aktakuza, ku në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale sulmi, nga neni 187 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ku për këtë gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe ia shqiptoi dënimin me gjobë në shumë prej 150 € (njëqind e pesëdhjetë) euro.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 dhe 74 të KP-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Kështu, gjykata nuk gjeti ndonjë rrethanë posaçërisht rënduese sa i përket të akuzuarit F.H., ndërsa gjykata si rrethanë lehtësuese e cila do të ndikonte në llojin dhe lartësinë e dënimit konsideron faktin se i pandehuri ka pranuar veprën penale, është penduar për atë se çfarë ka ndodhur dhe premtimin që në të ardhmen do të jetë me i kujdesshëm e të mos përsërisë më vepra të tilla të kundërligjshme.

Andaj duke u bazuar në këto rrethana, gjykata të akuzuarit i shqiptoi sanksionin penal sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke konsideruar se sanksioni i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë penalo-juridike të tij dhe se me këtë sanksion do të arrihet qëllimi preventiv i dënimit, që në të ardhmen i njëjti të jetë më i kujdesshëm dhe të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale, gjykata e mori në kuptim të nenit 450, 451 dhe 453 të KPPRK-së.

Vendimi mbi pagesën e kompensimit për Fondin e Kompensimit të Viktimave është marrë në kuptim të nenit 6 dhe 39 par. 3 pika 1 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensim të Viktimave të Krimin.

Vendimi për udhëzimin e të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest të rregullt civil është marrë në pajtim me nenin 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2018:016931
Datë: 23.08.2021
Numri i dokumentit: 02107718

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL
P.nr.1012/2020 të datës 13.08.2021
2018:016931, 13.08.2021

Bashkëpunëtori profesional
Uran Zogaj

Gjyqtarja
Shpresa Emra

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimin të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.